

EDUKIMI SHËNDETËSOR DHE FIZIK

Pyetje të Bëra Shpesh

Çfarë është kurrikula e rishikuar e Edukimit Shëndetësor dhe Fizik?

Kurrikula e Edukimit Shëndetësor dhe Fizik udhëzon mësuesit ndërsa ndihmojnë të gjithë studentët të fitojnë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të bërë jetë të shëndetshme dhe aktive. Kurrikula nuk është krejt e re - thjesht është përditësuar. Pjesa më e madhe e kurrikulës është përdorur në shkollat tona që prej vitit 1998. Zhvillimi i kësaj kurrikule është bërë në bazë të kërkimeve shkencore, konsultave nga akademikë dhe ekspertë në fusha të ndryshme të studimit (përfshirë shëndetin mendor, shëndetin publik, shëndetin seksual, edukimin fizik, kineziologjinë) dhe pas diskutimeve me prindër, mësues dhe nxënës.

Kur pritet të përdoret kurrikula e re në shkollat HWDSB?

Kurrikula e rishikuar do të fillojë të vihet në zbatim në shtator 2015. Megjithatë, nuk do të jepet mësim për shëndetin seksual deri në pranverë 2016.

Si do ta marrin vesh prindërit kur do të fillojë mësimdhënia e shëndetit seksual?

Në nivel klase, prindërit duan të dinë se kur do të diskutohet kjo temë në mësim. Të gjitha shkollat HWDSB do t'u dërgojnë letra prindëve në shtëpi në çdo nivel klase, të paktën **një muaj** para se mësuesit të mbulojnë shëndetin seksual në kurrikulë.

Ku mund të gjej më shumë informacion mbi kurrikulën e re mësimore të Edukimit Shëndetësor dhe Fizik?

Ministria e Arsimit ka përgatitur materiale për prindërit në disa gjuhë. Disa prej burimeve kyçe që sigurohen janë:

- Kopje të kurrikulës të Edukimit Shëndetësor dhe Fizik për ciklin fillor dhe të lartë
- Udhëzime për prindërit lidhur me Edukimin Shëndetësor dhe Fizik
- Paraqitje e përgjithshme sipas klasave për prindërit lidhur me kurrikulën e Edukimit Shëndetësor dhe Fizik
- Fakte kryesore për prindërit mbi Edukimin Shëndetësor dhe Fizik

Këto gjenden online në <http://www.edu.gov.on.ca/eng/curriculum/elementary/health.html> (për një fokus të ciklit fillor) dhe <http://www.edu.gov.on.ca/eng/curriculum/secondary/health.html> (për një fokus të ciklit të lartë).

A do të ketë seanca me prindërit nëse kam pyetje rreth kurrikulës të re?

Po, ka tre seanca informimi. Këto janë një mundësi që prindërit të bëjnë pyetje, që pyetjet e tyre të marrin përgjigje dhe të mësojnë më shumë rreth kurrikulës.

Ju lutem ndihuni të lirë të merrni pjesë në secilën prej seancave më poshtë:

E mërkurë, 4 nëntor

Dr. Davey 99 Elementary Ferguson Ave. N., Hamilton nga ora 3:30 deri në 5 pasdite.

E enjte, 5 nëntor

Saltfleet Secondary 108 Highland Rd. W., Stoney Creek nga ora 7 deri në 9 pasdite

E martë, 10 nëntor.

Sir Allan MacNab Secondary 145 Magnolia Dr, Hamilton nga ora 7 deri në 9 pasdite

Po nëse mendoj që ky material nuk është i përshtatshëm për moshën e fëmijës tim?

Me respektin dhe ndjeshmërinë e nevojshme, ne do t'u përgjigjemi pyetjeve dhe shqetësimeve tuaja në lidhje me materialin e parashtruar kurrikulë. Ju inkurajojmë që ta diskutoni këtë problem me mësuesin e fëmijës tuaj në mënyrë që të mësoni më shumë rreth praktikave mësimore dhe burimeve që do të përdoren për t'i dhënë mësim fëmijës tuaj. Nëse, pasi keni folur me mësuesin, përsëri keni shqetësime për mënyrën se si do të jepet mësim mbi shëndetin seksual, ju lutem kontaktoni drejtorin e shkollës të fëmijës tuaj.

Si mund të kërkoj që fëmija im të mos marrë pjesë në këto klasa mësimore?

Të gjitha shkollat HWDSB do t'u dërgojnë letra prindërve në shtëpi për çdo nivel të klasës të paktën **një muaj** para se mësuesit të mbulojnë shëndetin seksual në kurrikulë. Nëse, pasi të keni folur me mësuesin, përsëri besoni se fëmija juaj duhet të përjashtohet nga mësimet mbi shëndetin seksual, ju lutem kontaktoni drejtorin e shkollës të fëmijës tuaj. Stafi ynë do të përpiqet të gjejë një zgjidhje në bazë të rasteve specifike.

A mund të penalizohet fëmija im për mospjesmarrje në mësim në qoftë se nuk merr pjesë në orët mësimore të shëndetit seksual?

Nxënësit nuk do të penalizohen për mospjesmarrje në mësim.